



RREGULLORE E PËRGJITHËSHME E SHKOLLËS

Duke u bazuar në Ligjin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Ligjit numër 04L/138 Për Arsimin dhe Aftesimin Profesional, me theks te veqant neni 3, 4,5 pika 1 dhe 2, neni 6 pika 1, neni 7 pika 1, neni 8, neni 11 pika 2 pika 6, neni 18 pika 1, 2, 3, neni 24 pika 1 nenpika 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, neni 31, Ligjit numer 04L/143, nenit 4 pika 1, Ligji i Punes Nr. 03/L-212, UA (MASHTI) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta, Udhezimi Administrativ 01/2023, zgjedhja themelimi dhe funksionimi i Kshillit të Prindërve, Udhezimi Administrativ nr. 04/2021 Për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Këshillit të Nxënësve, Akteve Ligjore tjera qe lidhen me këtë veprimtari arsimore si dhe Statutin e IAAP "Keka-Med" Klinë të dt. 16.06.203.2.2010, Keshilli drejtues i IAAP "Keka-Med" miraton këtë:

RREGULLORE

Të drejtat dhe detyrat për:

KËSHILLIN DREJTUES.
KËSHILLIN E NXËNËSVE
KËSHILLIN E PRINDËRVE
KOORDINATORI I CILËSISË (SC)
MËSIMDHËNËSIT;
NXËNËSIT E SHKOLLËS;
PUNËTORËT E MIRËMBAJTJES;
PËR ROJET;

KAPITULLI I

Këshilli Drejtues i shkollës

Neni 1

Neni 1.1 Këshilli Drejtues i Shkollës konsolidohet dhe funksionon ne baze te Udhezimit Administrativ 34/2013.

Neni 1,2 Këshilli Drejtues i SHKollës, ka si mision të sigurojë që shërbimi shkollor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit të shkollës.

Neni 1.3 Detyrat e Këshillit Drejtues i Shkollës janë si më poshtë:

- Miraton planin afatmesëm të shkollës (PZSHS)
- Miraton planin vjetor të shkollës
- Miraton raportin vjetor të shkollës dhe raportin e saj financiar
- Harton rregulloren e brendshme të shkollës
- Përpiqet të sigurojë kontribute të komunitetit, të biznesit dhe të qeverisë lokale në mbarëvajtjen e shkollës;
- Miraton projektet e bashkëpunimit me institucionet e tjera
- Miraton veprimtaritë që kryen shkolla për komunitetin (pas mësimit)

Pavarsia profesionale e këshillit Drejtues të Shkollës

Neni 2

Neni 2.1 Këshilli Drejtues i sShkollës, respekton pavarësinë profesionale të personelit shkollor.

Neni 2.2 Këshilli DSH nuk ndërhyt në:

- Përzgjedhjet mësimdhënëse-mësimnxënëse të mësuesve, por ka te drejte pjesemarrjeje ne intervistimin kandidatave;
- Vlerësimin e nxënësve.

Përberja e Këshillit Drejtues të Shkollës

Neni 3

Neni 3.1 Këshilli Drejtues i SHkollës zgjidhet nga radhët e mësimitdhënësve të shkollës , përfaqësuesve të prindërve përfaqësues i nxënësve dhe dy anetare te komunitetit te biznesit.

Neni 3.2 Mësimitdhënësit e shkollës nga radhët e veta zgjedhin në mesin e shumë kandidatëve 3 përfaqësues në Këshillin e shkollës.

Neni 3.3 Prindërit e nxënësve të shkollës nga radhët e veta në mesin e më shumë kandidatëve zgjedhin 3 përfaqësues në Këshillin e shkollës.

Neni 3.4 Dy anëtarë të komunitetit të biznesit të emëruara/ regjistruara në komunë.

Neni 3.5 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Shkollës bëhet me vota të fshehta.

Neni 3.6 Mandati i anëtarëve zgjat tre vite me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat të dytë me kusht që ata të jenë prindër të nxënësve, mësues apo nxënës të shkollës.-

Neni 3.7 Kryetari i këshillit zgjedhet çdo vit nga vetë këshilli nga radhët e përfaqësuesve të prindërve më vota të fshehta në mesin e më shumë kandidatëve, mund të rizgjidhet.

Themelimi i Këshillit Drejtues të Shkollës

Neni 4

Neni 4.1. Këshilli Drejtues i SHkollës themelohet menjëherë pas ngritjes së qeverive të nxënësve, këshillave të prindërve të klasave dhe këshillit të prindërve të shkollës.

Neni 4.2 Kryetari i Këshillit Drejtues i SHkollës zgjidhet në mbledhjen e parë me shumicë votash.

Neni 4.3 Mbledhja e parë drejtohet nga drejtori ose nga anëtari me moshë më të madhe.

Neni 4.5 Kryetari i Këshillit Drejtues të SHkollës zgjidhet një herë në vit.

Neni 4.6 Mbledhja për shkarkimin e kryetarit të Këshillit Drejtues të SHkollës zhvillohet kur këtë e kërkojnë të paktën katër anëtarë të KDSH-se.

Neni 4.7 Mbledhja për shkarkimin e kryetarit të bordit mund të zhvillohet nëse në të marrin pjesë të paktën 3/5 e anëtarëve të bordit.

Neni 4.8 Votimi për shkarkim është i fshehtë.

Neni 4.9 Kryetari shkarkohet me votat e më shumë se gjysmës së pjesëmarrësve.

Funksionimi i Këshillit Drejtues të Shkollës

Neni 5

Neni 5.1 Këshilli Drejtues i Shkollës mbledhet cdo tre muaj në seanca të zakonshme dhe sipas rastit në seanca jashtë radhe.

Neni 5.2 Seancat jashtë radhe zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit, me nismën e të paktën katër anëtarëve të bordit ose me kërkesën e drejtorit të shkollës që i drejtohet kryetarit të bordit.

Neni 5.3 Kryetari i Këshillit Drejtues të SHkollës mund të ftojë ndonjë zyrtar të DKA-së dhe ka të drejtë të ftojë edhe zëvendës drejtorët, mësuesit, etj.

neni 5.4 Vendimet, që kanë të bëjnë me emra njerëzish dhe me probleme financiare merren gjithnjë me votim të fshehtë.

Neni 5.5 Mbledhjet e bordit zhvillohen kur marrin pjesë jo më pak se 3/5 e anëtarëve të bordit.

Neni 5.6 Në raste urgjencash mbledhja zhvillohet me shumicën e thjeshtë.

Neni 5.7 Kryetari i Këshillit Drejtues të SHkollës i dorëzon drejtorit të shkollës raportin/ekstraktin e mbledhjes së bordit

Neni 5.8 Vendimet e Këshillit Drejtues të Shkollës firmosen nga kryetari, por nuk kanë nevojë për vulë.

Neni 5.9. Dokumentet e Këshillit Drejtues të Shkollës mbahen dhe sigurohen në kasafortën e drejtorit, kundrejt inventarit përkatës.

Neni 5.10 Veprimtaria e bordit nuk paguhet.

Drejtori i Shkollës

Neni 6

Neni 6.1 Drejtori i shkollës është antar i Këshillit Drejtues të Shkollës në cilësinë e sekretarit të Këshillit.

Neni 6.2 Drejtori i shkollës kundrejt Këshillit Drejtues të Shkollës ka për detyrë:

- a) T'i paraqesë Këshillit Drejtues të Shkollës për miratim planin zhvillimor katërvjeçar të shkollës;
- b) T'i paraqesë Këshillit Drejtues të Shkollës për miratim planin vjetor të shkollës;
- c) T'i paraqesë Këshillit Drejtues të Shkollës për miratim raportin vjetor të veprimtarisë së shkollës si dhe raportin financiar;
- d) T'i paraqesë Këshillit Drejtues të Shkollës për miratim rregulloren e brendshme të shkollës;
- e) Të informojë periodikisht Këshillit Drejtues të Shkollës për arritjet e nxënësve të shkollës;
- g) T'i raportojë Këshillit Drejtues të Shkollës për çështje të mbarëvajtjes së shkollës për të cilat kryetari i bordit i paraqet drejtori kërkesë me shkrim.

KAPITULLI II

Këshilli i Nxënësve.

Neni 7

Neni 7.1 Këshilli i Nxënësve është një strukturë organizative e pavarur e nxënësve në shkollë. Ajo përfaqëson mendimin e masës së nxënësve për çështjet e shkollës, mësimin dhe edukimin të tyre.

Neni 7.2 Nëpërmjet Këshillit të Nxënësve sigurohet pjesëmarrja aktive e tyre në proceset e ndryshme demokratike në shkollë dhe në komunitet.

Neni 7.3 Këshilli i Nxënësve themelohet në bazë shkollë me pjesëmarrjen e gjithë nxënësve të shkollës dhe është çështje e iniciativës së lirë sipas kushteve dhe mundësive konkrete që ka shkolla.

Neni 7.4 Organet e qeverisjes janë përfaqësuese të masës së nxënësve të shkollës (çdo klasë nga një përfaqësues nga kryetari i klasës nga nxënësit).

Neni 7.5 Organi kryesor i Këshillit është Asambleja, e cila përbëhet nga asambleistët e rinj. Parimet e zgjedhjes dhe aktivitetet e organeve të Këshillit të nxënësve i përcakton rregullorja e miratuar me shumicë votash me votim të fshehtë, të barabartë dhe të përgjithshëm.

Neni 7.6 Rregullorja e Këshillit të Nxënësve nuk lejohet të bjerë ndesh me legjislacionin e arsimit parauniversitar në Fuqi.

Neni 7.7 Këshilli i Nxënësve mund t'i paraqesë drejtorit të shkollës apo këshillit të arsimtarëve, kërkesa për të gjitha çështjet e shkollës, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave themelore të nxënësve, të tilla si:

- a) E drejta për t'u njohur me programet mësimore, që zhvillohen në shkollë, përmbajtjen, realizimin dhe kërkesat e tyre.
- b) E drejta për vlerësim publik dhe të motivuar të përparimit në mësim dhe në sjellje.
- c) E drejta për organizimin e jetës në shkollë, duke ruajtur raportet e vendosura midis angazhimit mësimor dhe mundësive për zhvillimin e interesave vetjake.
- d) E drejta për organizimin e veprimtarive kulturore, arsimore, sportive dhe argëtuese në marrëveshje me drejtorinë e shkollës, duke bashkëpunuar edhe për zbatimin e respektimin e planit vjetor të punës së shkollës.
- e) E drejta për botimin e gazetës së shkollës.
- f) E drejta për të zgjedhur mësuesin që do të kryejë rolin e mësuesit koordinator të Këshillit të nxënësve, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës.
- g) E drejta për të mos u keqtrajtuar e diskriminuar në shkollë etj.

Neni 7.8 Këshilli i nxënësve në shkollë, me qëllim mbështetjen e veprimtarisë statutores të shkollës përkatëse, grumbullon fonde nga burime të ndryshme si kartat e regjistrimit, kontributet vullnetare, donatorë, etj. Në rast nevojë.

Neni 7.9 Brenda shkollës, sipas mundësive, Këshillit të nxënësve i caktohet nga drejtoria e shkollës një mjedis, i cili përdoret nga Asambleja si zyrë dhe vend mbledhjesh.

Neni 7.10 Në shkollat ku vepron struktura e qeverisjes, Kryetari i Këshillit të nxënësve është anëtarë i bordit të shkollës, si përfaqësues të masës së nxënësve (në rast se shkolla ka mbi 1000 nxënës).

Neni 7.11 Në mbledhje të Këshillit të Arsimit ose të drejtorisë së shkollës, në përshtatje me tematikën e mbledhjes, mund të ftohet të merr pjesë kryetari/ja i Këshillit të Nxënësve .

Neni 7.12 Kryetari është udhëheqës i Asamblesë, udhëheqë mbledhjet dhe cakton mbajtjen e mbledhjeve, kohën e mbajtjes dhe rendin e ditës. Mbledhjet e Asamblesë caktohen shtatëdhjetë e dy orë para mbajtjes në mënyrë që Asambleistët të ken kohë për t'u përgatitur dhe të jenë sa më aktiv në punën e tyre. Kryetari është i pari i Asamblesë, ka të drejtë të shkarkoj çdo anëtarë të kabinetit për moskryerjen e detyrave dhe çdo delegat të Asamblesë që është mospërfillës i obligimeve dhe detyrave që dalin nga kjo rregullore.

Neni 7.13 Kryetari duhet të jetë shembull për të mirë: i shkëlqyeshëm në procesin mësimor, sjellje shembullore, korrekt në punë, i shoqërueshëm në çdo aspekt, pra të jetë nxënës autoritativ. Kryetari e ka të drejtën që të përfaqësojë shkollën nëpër aktivitete të ndryshme me karakter mësimor dhe kulturor në nivel të Komunës, Republikës apo edhe më gjërë.

Neni 7.14 Nëse kryetari nuk i përmbush kryerjet nga pikat e sipërme obligative, ai/ajo mund të marr vërejtje dhe të shkarkohet nga detyra me shumicën e votave të delegatëve (kryetarëve të klasëve që janë në Asamblesë Rinore). Në rast të mungesës së kryetarit, detyrat dhe obligimet i kalohen nënkryetarit.

Neni 7.15 Kryetari me përpikëri duhet përmbajtur rregullores së punës. Në rast pakënaqësie me aktivitetin e vetë apo të Asambleistëve ai mund të jap dorëheqje para Asamblesë dhe detyrat t'ia kaloj nënkryetarit deri në zgjedhje të kryetarit të ri.

Neni 7.16 Nënkryetarit në rast të mungesës së kryetarit i kalohen të gjitha detyrat dhe obligimet e kryetarit.

Neni 7.17 Arkëtarit ka detyra dhe obligime të njejta sikurse ai i paralelës me të vetmin ndryshim se tani është arkëtar i tërë shkollës.

Neni 7.18 Kabineti i asamblesë.-përbëhet nga:

- Grupet sportive,
- Grupi i vallëzimit kombëtar,
- Grupi i vallëzimit modern
- Grupi i literar, recitativ dhe dramatik .
- Grupi i vullnetarëve.
- Grupi i teknikëve të rinj
- Grupi i shkencëtarëve.

KAPITULLI I III

Këshilli i Prindërve të Klasës.

Neni 8

Neni 8.1 Me qëllim që t'u jepet edukatorëve (prind – mësues) mundësia për ballafaqim e ndihmë reciproke duke harmonizuar punën edukative të secilit grup për çdo klasë përveç këshillit të mësimdhënësve, krijohet këshilli i klasës me përfaqësues të prindërve.

Neni 8.2 Këto këshilla thirren nga Kryetari i Prindërve të klasës, sipas rastit dhe patjetër së paku një herë në semester.

Neni 8.3 Detyra specifike e këshillave të klasës është të formulojë propozime sipas rregullit të punës edukative të përcaktuar për t'i integruar këto në mënyrë të drejtë didaktike e për më tepër të mundësojë e të shtrijë lidhjet ndërmjet mësuesve, prindërve e nxënësve.

Neni 8.4 Realizimi i koordinimit didaktik dhe i lidhjes ndërlëndore, si dhe vlerësimi periodik e përfundimtar i nxënësve, është detyrë e Këshillit të mësuesve të klasës vetëm me pjesëmarrjen e mësuesve.

KAPITULLI I IV
Këshilli i Prinderve të Shkollës.
Neni 9

Neni 9.1 Këshilli i Prinderve të shkollës është i përbërë nga 18 anëtarë, të cilët janë kryetarët e prinderve të klasave.

Neni 9.2 Këshilli në mbledhjen e parë, zgjedh me shumicë absolute votash Kryetarin e Prinderve të Shkollës.

Neni 9.3 Këshilli i Prinderve të Shkollës, duke mos ndërhyrë në kompetencat e Këshillit të Mësuesve e të këshillave të klasave, ka fuqi të vendosë përsa i përket organizimit e programimit të jetës e të aktivitetit të shkollës në sferat e mëposhtme:

- a) Aprovim e modifikim i rregullores së brendshme të shkollës
- b) Mendime dhe ndihme për ripërtëritje e ruajtje e pajisjeve laboratorike e mjeteve didaktike, si dhe pasurimin e bibliotekës.
- c) Nxitja e kontakteve me shkolla të tjera edhe jashtë vendit, me qëllim të realizimit të shkëmbimit të informacionit e të eksperiencës për të ndërmarrë nisma të ndryshme të bashkëpunimit.
- d) Pjesëmarrje e shkollës në aktivitete kulturore, sportive e rikrijuese.
- e) Gjetje formash dhe mënyrash për zhvillimin e nismave të solidaritetit, që mund të merren nga shkolla.

Neni 9.4 Këshilli i Prinderve të Shkollës ka fuqi konsultative përsa u përket kritereve të programit e të vënies në jetë të aktiviteteve jashtëshkollore.

Neni 9.5 Kryetari i Prinderve të Shkollës thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit, cakton rendin e ditës sipas propozimeve paraprake të drejtorit apo Këshillit të Arsimitarëve apo të këshillave të ndryshme të klasave.

Neni 9.6 Sekretari i Këshillit mban një procesverbal për çdo mbledhje të Këshillit dhe e lexon atë në mbledhjen pasardhëse.

Neni 9.7 Këshilli i Prinderve të Shkollës zgjidhet për çdo vit dhe ushtron funksionet e veta derisa të marrë funksionet Këshilli i ri.

Neni 9.8 Data, ora dhe rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit i Prinderve të Shkollës vendosen në përfundim të mbledhjes së fundit: në rast të kundërt, Kryetari i Prinderve të Shkollës, merr masa që këshilltarët të paralajmërohen të paktën pesë ditë përpara ditës së caktuar. Në rast urgjence, thirrja për mbledhje bëhet nga Kryetari i Prinderve të Shkollës në kohën më të shkurtër e me çdo mjet.

KAPITULLI IV
Koordinatori i Sigurimit të Cilësis.
Neni 10

Neni 10.1 Në nivel shkollë, koordinatori për sigurim të cilës, ka detyra si:

- a) Planifikon, organizon dhe monitoron procesin e sigurimit të cilësis së shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës;
- b) Ndihmon drejtorin e shkollës dhe organet tjera qeverisëse e profesionale të shkollës në procesin e hartimit të planit zhvillimor të shkollës dhe planit të veprimit;
- c) Informon drejtorin e shkollës dhe mësimmshënësit, për qeshtjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësis së shkollës;
- d) Së bashku me drejtorin e shkollës dhe me stafin e shkollës, kontribuon në zhvillimin e projekteve dhe proceseve për të zbatuar masat e sigurimit të cilësis në shkollë;
- e) Bashkëpunon me drejtorin e shkollës dhe me stafin e shkollës për planifikim, organizim dhe zbatim të vetëvlersimit të progresit në fushat e cilësis së shkollës;
- f) Koordinatori i cilësis me bashkëpunim me aktivet profesional të shkollës, sigurohet që të gjithë mësimmshënësit kanë përgatitur planet e nevojshme vjetore, dy mujore, javore e përgatitjet ditore, sipas kërkesave të udhëheqjes së shkollës dhe nevojave për zbatim me sukses të kurikulës së re;

- g) Së bashku me stafin e shkollës, analizon dhe interpreton rezultatet e vetëvlersimit të shkollës;
- h) Raporton mbi procesin e menaxhimit të cilësisë dhe rezultatet e tij, tek drejtori i shkollës dhe antaret e stafit.

KAPITULLI VII Mësimdhënsit (Arsimtarët) Neni 11

Neni 11.1 Çdo dëm brenda klasës do të paguhet, nëse nuk gjendet nxënësi, përgjegjësia bie mbi mësimdhënësin Përkatës.

Neni 11.2 Çdo arsimtar duhet të caktojë një orar të konsultimeve individuale me prindër dhe komunitet, kështu takimet me prinder nuk tolerohen ne orare tjera.

Neni 11.3 Ditën e kujdestarisë arsimtarët që caktohen duhet të qëndron në vend të caktuar tërë ndërrimin, duke qene te paktën 30 minuta ne shkolle, para se te fillojë mësimi, (edhe nese nuk kane mesim ne oret e para mesimdhenesit qe kane me shume se 10 ore pune mesimore ne shkollen tone, duhet te jene ne vendin e kujdestarise nga ora 7:30).

Neni 11.4 Vonesat dhe mungesat e punëtorëve pa arsye, sanksionohen me heqje të meditjeve në pagë mujore.

Neni 11.5 Çdo vërejtje që shënohet në ditar dhe çdo nxënës që ka me shume se 10 mungesa pa arsye te paraqitet meshkrim ne drejtori, nga kujdestari i klasës.

Neni 11.6 Planet të dorëzohen me kohë më së largu deri më datën/ditën e fundit te muajit paraprak.

Neni 11.7 Pa uniforma nuk mund te hyjnë në shkollë (pasi të pajisen me uniforma).

Neni 11.8 Kabinetet dhe hapësirat e shkollës të shfrytëzohen vetëm për punë, ndërsa për t'u ushqyer është kantina.

Neni 11.9 Arsimtarët nuk duhet që t'i lirojnë nxënësit gjate orës së mësimi pa arsye dhe nuk kanë të drejtë t'i largojnë nga procesi mësimor.

Neni 11.10 Në rast se duhet ti lirojnë nxënësit nga ora mesimore, duhet t'u shkruajnë një letër që përmban:

Orën
mesimore, datën, arsyen e lirimit nga ora dhe emrin e nënshkrimit e mësimdhënësit.

Neni 11.11 Veshja e mësimdhënësve duhet të jetë në përputhje me Kodin Etik të Veshjes, si dhe nuk duhet të mbathin taka.

Neni 11.12 Ndalohen grupacionet, shpifjet, organizimet e ndryshme pa dijeninë e drejtorisë në lokalet e shkollës, devijimi (keqinterpretimi) i informatave zyrtare tek prindërit dhe komuniteti dhe çdo lloj veprimi që bie ndesh me legjislacionin dhe kulturën dhe zhvillimin e shkollës (që janë të miratuara në PZHSH nga organet qeverisëse të shkollës).

Neni 11.13 Çdo orë mesimore e humbur, jashtë pushimeve që përcaktohen me Ligj (psh. lehonisë, mjekësor, etj.), duhet të zëvendësohet në ditët në vijim, pas procesit mësimor (apo orën e shtatë).

Neni 11.14 Të gjithë mësimdhënësit, duhet të zbatojnë këtë rregullore në përpikmëri si dhe kontratën e punës, Ligjin, udhëzimet administrative, vendimet komunale dhe kerkesat e drejtorisë së shkollës.

KAPITULLI VIII Nxënsit e Shkollës. Neni 12

Neni 12.1 Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollës se Mesme te Mjekesis Keka Med Klinë / shkeljet e rregullave dhe detyrave të nxënësve, masat disiplinore, procedurat për vërtetimin e përgjegjësisë së nxënësit, kompetencat e organeve të shkollës mbi inicimin,

zhvillim procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore, të drejtat e nxënësit për ankesë, përgjegjësia materiale për dëmin material të shkaktuar shkollës, si dhe dispozita tjera.

Neni 12.2 Nxënësit janë pjesëmarrës aktiv në punën edukativo-arsimore dhe së bashku me mësuesin, bashkëpunëtorët profesionalë dhe punëtorët tjerë, janë përgjegjës për rezultatet e punës arsimore – edukative.

Neni 12.3 Shkolla është e obliguar që në fillim të vitit shkollor, por edhe kohë pas kohe, përmes kujdestarëve të klasave, t'i njoftojë nxënësit me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 12.4 Kujdestari i klasës nga radha e arsimtarëve, në fillim të vitit shkollor, veçanërisht gjatë mbajtjes së orëve të kujdestarisë, ka për obligim që t'i njoftojë nxënësit me Rregulloren e Shkollës.

Neni 12.5 Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejshme dhe zbatohen për sjelljet/veprimet e nxënësve në:

- a) oborrin e shkollës (në çdo kohë);
- b) jashtë oborrit të shkollës, në aktivitete apo ngjarje shkollore;
- c) jashtë hapësirës së shkollës kur sjellja mund ta dëmtojë autoritetin e duhur disiplinor të shkollës ose të rrezikojë sigurinë e anëtarëve të komunitetit të shkollës, të përçajë komunitetin e shkollës
- d) gjatë udhëtimeve shkollë-shtëpi dhe anasjelltas, duke përfshirë (por jo kufizuar), veprime në çdo autobus, furgon shkolle ose transport publik.

Neni 12.6 Një kopje e rregullores duhet të jetë e publikuar në tabelën e njoftimeve të shkollës për t'u njoftuar me të, të gjithë nxënësit dhe mësuesin e shkollës dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

Neni 12.7 Drejtori i shkollës është autoritet, i cili ka për obligim të sigurojë zbatimin e saj dhe të trajtojë në përputhje me këtë rregullore çdo rast që bie ndesh me të.

Neni 12.8 Përgjegjësitë e parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje drejtori i shkollës mund t'i bartë tek ndonjë person i autorizuar brenda shkolles.

Të Drejtat e Nxënësit

Neni 13

Neni 13.1 Nxënësi ka të drejtë:

- a. në shkollim, sipas dispozitave ligjore në fuqi,
- b. të shfaqë lirisht mendimin e tij në të gjitha format, gojarisht, me shkrim dhe publikisht për problemet që e shqetësojnë atë, klasën e tij apo shkollën në tërësi,
- c. të kërkojë mbrojtje nga dhuna fizike e psikologjike dhe t'i respektohet dinjiteti në shkollë,
- d. të njohë konventat e të drejtave të fëmijëve dhe të kërkojë respektimin e tyre nga të
- e. tjerët,
- f. të marrë pjesë në mbledhjet e ndryshme të klasës dhe të shkollës,
- g. dh) të ankohet në drejtorinë e shkollës ose në organet më të larta të arsimit, kur gjykon se i është bërë e padrejtë,
- h. të marrë pjesë në veprimtaritë kulturore, artistike, sportive që zhvillon klasa ose shkolla, të kërkojë dhe të marrë dokumentin përkatës pedagogjik-shkollor për mbarimin e klasës dhe të shkollës, apo kur largohet në një shkollë tjetër, ë. të marrë nga arsimtari punimet me shkrim për të studiuar dhe analizuar, të ndjekë rregullisht mësimin dhe format tjera të organizuara të punës edukativo-arsimore, të përcaktuara me programin vjetor të punës së shkollës,
- i. t'i shfrytëzojë mjetet mësimore të punës dhe mjetet tjera të institucionit edukativo-arsimor me të cilat zhvillohet programi i punës arsimore-edukative,
- j. të ketë siguri fizike dhe shëndetësore gjatë praktikës profesionale në shkollë ose në punëtori,
- k. të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organizatat rinore të shkollës dhe në organet tjera, dhe ka të drejtë të marrë pjesë në gara të diturisë, sportive dhe kulturore, për të cilat edhe mund të shpërblehet, të avancohet në bazë të suksesit të përgjithshëm dhe talentit të treguar në lëmë të veçantë sipas dispozitave në fuqi.

Obligimet e Nxënësit
Neni 14

Neni 14.1 Nxënësi ka për detyrë dhe obligim që:

1. të njohë dhe të respektojë kodin e mirësjelljes dhe rregullat e shkollës,
2. të respektojë orarin e mësimi, të përcaktuar nga institucioni edukativo – arsimor,
3. të jetë pedant dhe i pastër,
4. t'i respektojë arsimtarët, punëtorët tjerë të shkollës dhe shokët e shoqet e klasës,
5. të mbajë qëndrim të mirë dhe të mos bëhet pengesë për zhvillimin normal të orës
6. së mësimi,
7. të shkojë në shkollë i pajisur me tekste, fletore e mjete të tjera të domosdoshme,
8. të ketë uniformën e caktuar për lëndën e edukatës fizike dhe uniformen shkollore,
9. të ketë uniformën shkollore gjatë zhvillimit të procesit edukativo-arsimor dhe gjatë
10. qëndrimit në shkollë,
11. në rastet kur është i sëmurë, ta arsyetojë atë me raportin mjekësor,
12. të njoftojë me kohë prindin e vet dhe t'ia dërgojë ftesën apo thirrjen nga ana e mësimdhënësit, kujdestarit të klasës, drejtorit të shkollës ose organet tjera të shkollës, sa herë paraqitet nevoja,
13. të mbajë pastër ambientin e klasës, të shkollës dhe ambientin përreth shkollës,
14. të kultivojë, të ruajë dhe të zhvillojë vlera të mirëfillta njerëzore, kombëtare dhe demokratike,
15. të ruajë pasurinë e shkollës,
16. të lajmërojë dëmin e shkaktuar në inventarin e shkollës,
17. të zbatojë rregullat e sjelljes dhe të punës në shkollë,
18. të jetë gjithmonë i përgatitur për mësim dhe praktikë profesionale.
19. të vijë në orarin e caktuar dhe të frekuentojë shkollën çdo ditë mësimi, duke respektuar orarin mësimor;
20. të mbajë qëndrim të drejtë e të edukuar/kulturuar në shkollë dhe jashtë saj;
21. të njohë dhe të respektojë detyrimet e përcaktuara në procesin mësimor të shkollës (lëndët, obligimet mësimore për çdo lëndë dhe obligimet javore);
22. të mësojë dhe të përgatitet sistematikisht në çdo lëndë; të kryejë me korrektësi dhe në përputhje me aftësitë e veta detyrat, që i ngarkohen nga mësimdhënësit dhe drejtoria e shkollës,
23. të respektojë rregulloret e shkollës, rendin shtëpiak, ligjet e zbatueshme, të mos pengojë mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në klasë, shkollë apo në aktivitete të tjera jashtëmësimore brenda dhe jashtë shkolle.
24. të respektojë e të mbajë qëndrim korrekt ndaj mësimdhënësve, drejtorisë së shkollës, personelit administrativ, teknik e ndihmës të shkollës, në mjediset brenda e jashtë shkollës;
25. të mbajë higjienën personale, të kujdeset dhe të kontribuojë për higjienën e klasës, të shkollës dhe të ambientit të jashtëm të shkollës,
26. janë të obliguar të bartin uniformën e përcaktuar nga Këshilli i Shkollës (duke përfshirë veshjet dhe mbathjet, përderisa mbathjet duhet të jenë papuqe (kllompe) apo atlete në ngjyrë të bardhë),
27. veshja e paraqitja e jashtme e tij/saj, të jetë korrekte, pa teprime, e përshtatshme me moshën që ai/ajo ka, në përputhje me normat e bashkëjetesës në shoqëri dhe me rregulloren e brendshme të shkollës, si dhe të mos grimosin fytyrat për transformim në dukje të jashtme;
28. të mos përdorë fjalë të pahijshme, të turpshme apo të pista;
29. të raportojë incidentet apo aktivitetet që mund të kërcënojnë apo të përçajnë ambientin shkollor tek një nga drejtuesit e shkollës (drejtori, zëvendësdrejtori, arsimtari kujdestar klase, arsimtari kujdestar dite etj.);
30. të respektojë detyra të tjera konform dispozitave ligjore, rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës,
31. nxënësit mund të qëndrojnë në shkollë gjatë kohës të caktuar për mësimdhënie, formave të tjera të arsimit, edukimit dhe aktiviteteve të lira gjithmonë në mbikëqyrje të personelit shkollor.
32. nxënësit janë të detyruar të vijnë në shkollë së paku pesëmbëdhjetë (15) minuta para se të fillojë mësimi dhe të largohen nga shkolla posa të përfundojnë aktivitetet edukativo-arsimore.

33. Çdo nxënës që vjen në shkollë me vonesë, do të qëndrojë për një orë mësimore në hollin e shkollës, si dënim për vonesë që të mos iu kalojë në shprehi vonesa.
34. në pushimin e “gjatë”, mund ti shfrytëzojnë hapësirat e përshtatshme brenda shkollës (ose në klasë), për t’u ushqyer dhe pesë (5) minuta para se të fillojë ora mësimore, duhet të jetë në klasë,
35. gjatë pushimit të “shkurtër”, nuk lejohet defilimi nëpër korridore kot, përveç derisa marrin mjetet mësimore nga dollapët e tyre,
36. Të shfrytëzohet vetëm hyrja përkatëse për të hyrë dhe për të dalë nga shkolla dhe asnjë hyrje tjetër që nuk është dedikuar për nxënës,
37. Të mos sillen nxënës apo persona që nuk janë të shkollës sonë;
38. Në objektin shkollor, (as brenda as jashtë 100m larg shkollës), të mos përdoret (as të bartet) duhani, alkooli apo substance tjera të dëmshme për shëndetin e njeriut;
39. Të mos barten me vete, gjësende të rrezikshme, siç janë armët e ftohta apo të tjera, përderisa janë vdekjeprurëse;
40. Të mos organizohen rrahje individuale apo grupe brenda dhe jashtë objektit shkollor;
41. Të ruhet e të mos dëmtohet inventari shkollor (banka, karrige, dritare, dyer, etj.); ngase në rast dëmtimi ato kompenzohen nga vetë nxënësit përkatësisht prindërit.
42. Të ruhet ambienti shkollor brenda dhe jashtë (të mos hudhen mbeturina);
43. Të mos organizohen: shëtitje, ahengje, apo aktivitete tjera, në emër të shkollës,
44. Të mos organizohen debate politike apo ideologjike, në lokalet e shkollës;
45. T’i njoftojnë prindërit me rastin e mbledhjes së prindërve apo tema tjera që janë të nevojshme për ti njoftuar prindërit;
46. Nuk lejohet lëvizja e nxënësve nëpër objektin shkollor, përgjatë orëve mësimore pa arsye, vetëm nëse kanë letrën arsyetuese nga mësimdhënësi i orës përkatëse.
47. Hyrja në sallën e arsimitarëve është e ndaluar;
48. Shkolla është e ndarë në tri nivele, andaj duhet të shfrytëzohen vetëm katet apo korridoret përkatëse të niveleve shkollore dhe assesi të defilohet në korridoret e nivelit fillor apo parafillor nga niveli i mesëm i ulët dhe anasjelltas.

Veprimet e Ndaluar Neni 15

Neni 15 Nxënësi e ka të ndaluar :

- a. të prishë disiplinën gjatë orës së mësimi (të bëjë zhurmë apo forma të tjera të pengesës për të tjerët),
- b. të prishë rendin dhe qetësinë në shkollë,
- c. të mbajë armë zjarri, armë të ftohtë ose gjësende të tjera të rrezikshme për jetën e nxënësve dhe personelit tjetër në shkollë, ofendojë shokët, shoqet ose mësimdhënësit,
- d. të hyjë me vonesë në orë të mësimi apo praktikë profesionale, të konsumojë duhan, pije alkoolike apo produkte narkotike,
- e. të kopjojë në klasë gjatë kryerjes së detyrave me shkrim, të marrë pjesë në lojëra me karakter bixhozi,
- f. të bisedojë me zë të lartë në mjediset e shkollës,
- g. të dëmtojë bazën materiale teknike dhe didaktike të shkollës, të bëjë mungesa pa arsye, të qëndrojë në korridore të shkollës pa nevojë, të lëvizë pa nevojë në pjesën e dedikuar për arsimitarë dhe në aneksin e administratës së shkollës,
- h. të hyjë në shkollë nga hyrja e dedikuar për personelin arsimor,
- i. të hyjë në sallën e arsimitarëve pa prezencën e kujdestarit të klasës, të arsimitarit kujdestar të ditës ose pa lejen e drejtorit të shkollës,
- j. të sjellë persona të huaj (të panjohur) në shkollë, pa paralajmërim në drejtorinë e shkollës,
- k. të përvetësojë në mënyrë të palejuar gjësendet e huaja,
- l. të falsifikojë të dhënat në dokumentet pedagogjike-shkollore (ditar, libër amzë, dëftesë, diplomë etj.),
- m. të përdorë telefonin celular gjatë orëve të mësimi dhe të orës praktike,

- n. të fusë dhe të konsumojë gjëra ushqimore në orët mësimore, dhe
- o. ndalesa të tjera të caktuara nga drejtori i shkollës.

Shkelja e Rregullave dhe Detyrave Punuese të Nxënësit Neni 16

Neni 16.1 Shkeljet e rregullave dhe detyrave punuese të nxënësit mund të jenë të lehta dhe të rënda.

Neni 16.2 Shkeljet e lehta të rregullave dhe të detyrave punuese të nxënësit janë:

1. Vonesa e paarsyeshme në orën e mësimi, prishja e disiplinës gjatë orës së mësimi (përdorimi i
2. çamçakëz, pëshpëritja me shokun e bankës, përdorimi i telefonit celular, etj.);
3. Hyrja në klasë pasi të ketë rënë zilha, kopjimi gjatë kryerjes së detyrave me shkrim në klasë,
4. prishja e rendit dhe e qetësisë në lokalet e shkollës duke lëshuar zë të lartë;
5. Hyrja në shkollë nga ana e dedikuar për personelin arsimor;
6. Qëndrimi i gjatë dhe pa arsye në korridore të shkollës, duke penguar procesin edukativo- arsimor;
7. Hyrja në sallën e arsimtarëve pa praninë e kujdestarit të klasës, të arsimtarit kujdestar të ditës ose pa lejen e drejtorit të shkollës;
8. Qëndrimi dhe lëvizjet pa nevojë nëpër shkallët e shkollës;
9. Mosrespektimi i udhëzimeve të kujdestarit të ditës;
10. Sjellja jo korrekte e nxënësit gjatë të pyeturit dhe notimit nga mësimitdhënësit;
11. Sjellja jo korrekte ndaj shokëve dhe shoqeve;
12. Sjellja e personave të panjohur në shkollë pa paralajmëruar drejtorinë e shkollës;
13. Konsumimi i duhanit në lokal, oborrin dhe në prani të shkollës;
14. Marrja në vërejtje nga arsimtari i lëndës;
15. Mungesa e paarsyeshme nga mësimi në mbi 15 orë mësimore gjatë gjysmëvjetorit të parë dhe 20 orë mësimore përgjatë gjysmëvjetorit të dytë shkollor (ku mund të vendoset për të përfundohet ai vit shkollor me provime klasore);
16. Përdorimi i telefonave celular ne objektin shkollor (perveç ne pushim te gjate);
17. Mos përdorimi i uniformes dhe mbathjeve te percaktuara nga Keshilli i Shkolles, etj.

Neni 16.3 Shkeljet e rënda të detyrave punuese të nxënësit janë:

1. Përmirësimi, ndryshimi (falsifikimi) i të dhënave në dokumentet pedagogjike-shkollore: (ditar, libër amzë, dëftesë, diplomë etj.);
2. Përvetësimi jo i lejuar (vjedhja) e pasurisë së nxënësit, arsimtarit dhe shkollës;
3. Mbajtja dhe përdorimi i alkoolit, duhanit dhe substancave narkotike;
4. Nxitja dhe pjesëmarrja në rrahje në shkollë dhe jashtë saj;
5. Mbajtja e armëve të zjarra, të ftohta, si dhe mjeteve tjera që e rrezikojnë jetën e nxënësve dhe personelit tjetër në shkollë;
6. Vetorganizimi i manipuluar dhe jo i drejtë i lëshimit frontal të orëve të mësimi apo i protestës së padrejtë ndaj mësimitdhënësve;
7. Konsumimi i duhanit në lokalet e shkollës;
8. Dëmtimi i bazës materiale teknike dhe didaktike të shkollës;
9. Mungesa pa arsye nga mësimi dhe nga format tjera të punës arsimore- edukative, me mbi 30 orë mësimi gjatë vitit shkollor;
10. Marrja e disahershme në vërejtje nga arsimtari i lëndës;
11. Shkaravitja, demtimi dhe mbishkrimi i mureve, dyerve, dritareve dhe inventarit të shkollës;
12. Përsëritja e shkeljeve të lehta të rregullores;
13. Sjellje tjera asociiale-devijuese që drejtori i shkollës, Këshilli i klasave dhe Këshilli i arsimtarëve i cilësojnë si shkelje të rënda dhe sjellje të dëmshme për mbarëvajtjen e jetës dhe punës në shkollë.

Normat e Disiplinës për Nxënësit Neni 17

1. Paraqitja në mësim sipas orarit shkollor është e detyrueshme për të gjithë.
2. Nxënësit që mungojnë në shkollë apo që vonohen në orën e parë apo tjerat, do të futen në hollin e shkollës deri sa të fillojë ora e ardhshme mësimore, që të mos i pengoj të tjerët në mësim.
3. Mungesat për arsye shëndetësore, justifikohen vetëm me raport mjeksor.
4. Nxënësit duhet të ndodhen brenda në klasë kur të bjerë zilja, që lajmëron fillimin e mësimit.
5. Kush arrin me vonesë pas orës së caktuar për fillimin e mësimit (në raste të rralla) mund të pranohet në klasë me miratimin e mesuesit kujdestar të klases, nëse jo qëndron në hollin e shkollës dhe askund tjetër.
6. Vonesat e shpeshta do t'u njoftohen familjeve dhe do të kenë masa disiplinore.
7. Gjatë kohës së mësimit duke përfshirë edhe pushimet asnjë nxënës nuk duhet të dalë nga shkolla pa leje të mësimdhënësit të orës apo drejtorisë (që do ta kenë me shkrim lejen për të dalë nga shkolla dhe roja e shkollës të ketë arsye për të liruar nxënësin të del nga shkolla).
8. Shkolla nuk mban asnjë përgjegjësi për daljet pa leje (në rast se nxënësit dalin nga dalja emergjente).
9. Kërkesa për t'u larguar nga shkolla, përpara përfundimit të mësimeve, duhet të motivohet e t'i drejtohet mesuesit kujdestar.
10. Kërkesa për të dalë para përfundimit të mësimeve e kërkuar nga prindi dhe e pranuar nga mesuesi kujdestar i heq shkollës çdo përgjegjësi që nga momenti në të cilin nxënësi del nga shkolla.
11. Nga të gjithë kërkohet një qëndrim korrekt dhe i edukuar. Në mjediset e shkollës nuk lejohen zhurma, shprehjet e pahijshme, çrregullimet, lojrat e papërshtatshme dhe dëmtimet e bazës materiale të shkollës.
12. Nxënësit janë përgjegjës për dëmtimin dhe prishjen e pajisjeve që i përkasin shkollës. Kush dëmton paguan. Drejtoria nuk përgjigjet për sendet vetiake që nxënësit sjellin dhe i harrojnë në shkollë (veshje, libra, para, etj.).
13. Ndalohet rreptësisht për të gjithë pirja e duhanit në ambientet shkollore dhe mbajtja e aparaturave telefonike, elektronike dhe lojërave.

Masat Disiplinore Neni 18

Neni 18.1 Për shkelje të lehta të rregullores, nxënësit i shqiptohet këto masa disiplinore:

- a) vërejtje gojore (qortim),
- b) vërejtje me shkrim.
- c) Vërejtjen gojore (qortim) e shqipton kujdestari i klasës, i cili në praninë e nxënësve të klasës i jep vërejtje gojore (qortim).
- d) Për këtë masë të shqiptuar njoftohet prindi i nxënësit dhe pastaj edhe drejtori I shkolles.

Neni 18.2 Për shkelje të rënda të rregullave dhe detyrave punuese, nxënësit mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore:

- a) pezullim (largim) i përkohshëm nga shkolla dhe
- b) pezullim (largim) për një vit shkollor nga shkolla;

Neni 18.3 Për mosvijueshmëri të rregullt në orët e mësimit teorik dhe praktikës profesionale:

- a) nxënësi, i cili mungon pa arsye 15 - 20 orë mësimi, sjellja e tij vlerësohet "*e mirë*",
- b) nxënësi, i cili mungon pa arsye 20 e më tepër orë mësimi, sjellja e tij vlerësohet "*jo e mirë*" dhe
- c) nxënësi i cili ka më tepër se 30 mungesa të paarsyeshme, e humb statusin e nxënësit
- d) të rregullt.

Neni 18.4 Nxënësve të cilët bëjnë shkelje të rregullave të sjelljes në shkollë, iu shqiptohen këto masa disiplinore:

- a) Vërejtje gojore (qortim), shqiptohet nga kujdestari i klasës;
- b) Vërejtje me shkrim, shqiptohet nga drejtori i shkollës;
- c) Pezullim (i përkohshëm) nga garat, ekskursionet, vizitat dhe shëtitjet, shqiptohet nga
- d) drejtori i shkollës;

- e) ç. Pezullim/suspendim nga shkolla deri në tri ditë (apo sipas udhezimit administrativ, deri në dy jave), nga drejtori i shkollës;
- f) Pezullim i përkohshëm, deri në një muaj, shqiptohet në marreveshje me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) dhe
- g) Pezullim (largim) nga shkolla për një vit shkollor, shqiptohet nga DKA-ja.

Neni 18.5 Masa disiplinore, nuk mund t'i shqiptohet nxënësit, nëse mungon deklarata me shkrim nga ana e nxënësit, përveç në rastet kur nxënësi në asnjë mënyrë nuk i përgjigjet kërkesës për deklaratë me shkrim. Prindi/kujdestari i fëmijës paraprakisht informohet-thirret me telefon.

Neni 18.6 Nxënësit mund t'i shqiptohet njëra nga masat disiplinore pas zbatimit të procedurës, në të cilën patjetër duhet të vërtetohen faktet dhe rrethanat mbi shkeljen e kryer (me deklarata me shkrim dhe me deshmitarë), me qëllim të shqiptimit të masës adekuate nga organi kompetent.

Procedura për Inicimin, Zhvillimin, Vërtetimin e Për Inicimin, Zhvillimin, Vërtetimin e Përgjegjësisë dhe shqiptimin e masave Disiplinore

Neni 19

Neni 19.1 Secili nxënës dhe punëtor i shkollës ka të drejtë dhe detyrë që, posa të marrë vesh mbi shkeljen e kryer, ta lajmërojë kujdestarin e klasës apo drejtorin e shkollës.

Neni 19.2 Inicimin e procedurës disiplinore mund ta bëjnë: kujdestari i klasës, kujdestari i ditës, Këshilli i Klasëve (paraleles), ose Këshilli i arsimtarëve.

Neni 19.3 Organi kompetent për shqiptimin e masës disiplinore ka për detyrë që kërkesën me shkrim për inicimin e procedurës disiplinore, ta shqyrtojë dhe të marrë vendim në afatin prej 8 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Neni 19.4 Zhvillimin e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë e bëjnë organet kompetente për shqiptimin e masave disiplinore, të përcaktuara me këtë Rregullore.

Për inicimin dhe zhvillimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore ndaj nxënësit, organet kompetente janë të obliguara ta njoftojnë prindin e nxënësit.

Prindi i nxënësit thirret me letërthirrje (ose telefon), të cilën nxënësi është i obliguar t'ia dërgojë me kohë prindit të vet.

Në qoftë se vërtetohet se nxënësi nuk e ka njoftuar prindin, por atij nuk ia ka dërguar thirrjen-ftesën, atëherë ky obligim i takon kujdestarit të klasës, i cili, në praninë e nxënësve, i kërkon nxënësit të firmosë se prindi i tij është njoftuar. Nëse nxënësi refuzon, atëherë kujdestari i klasës bën konstatim me shkrim në ditar në prani të nxënësve tjerë (dhe vazhdon procedurat në drejtori për thirrje të prindërve).

Neni 19.5 Për vërtetimin e përgjegjësisë duhet të zhvillohet procedura disiplinore, ku ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme dhe provat.

Për vërtetimin e përgjegjësisë mund të merren këto prova:

- a) dokumentet mbi evidencën pedagogjike-shkollore: ditari, libri amzë, dëftesa, diploma etj.,
- b) dëshmitarët (deklaratat e dëshmitarëve),
- c) shikimi në vendin e ngjarjes, etj.

Neni 19.6 Para shqiptimit të masës disiplinore, nxënësi duhet të dëgjohet dhe të japë mendimin e vet gojarisht apo me shkrim.

Nxënësi thirret për të dhënë mendimin e vet gojarisht apo me shkrim, menjëherë pas paraqitjes së kërkesës për inicimin e procedurës nga organi kompetent.

Neni 19.7 Në qoftë se nxënësi, edhe pse ka marrë vërejtje gojore (qortim) nga kujdestari i klasës, nuk përmirësohet, por vazhdimisht i përsërit shkeljet e rregullave në shkollë, atëherë kujdestari i klasës i propozon drejtorit të shkollës që nxënësit t'i shqiptohet masa disiplinore – vërejtje me shkrim, të cilën e shqipton drejtori i shkollës.

Vërejtje me shkrim i shqiptohet nxënësit edhe në rastet kur ato jepen nga arsimtarët e lëndëve, por edhe nëse ka munguar pa arsye nga mësimi më tepër se 20 orë mësimi.

Për shkelje të lehta që konsiderohen dhe konstatohen nga drejtori apo kujdestari i klasës, mund të dënojnë nxënësit me:

Punim të ndonjë projekti që ka të bëjë me fushën problemore të shkaktuar nga vet nxënësi,

Pastrim të objektit shkollor brenda dhe jashtë tij, se bashku me punëtorët teknik, Të lexojë libra të caktuara nga bibliotekarja apo ars. i gjuhës apo drejtori i shkollës ose ta ndihmojë bibliotekaren në klasifikimin e librave në bibliotekë.

Neni 19.8 Kujdestari i klasës është i obliguar që masat e shqiptuara, t'i evidencojë në librin e klasës (ditar) në rubrikën: *Procesverbali i Këshillit të klasës* dhe rubrikën: *Evidencimi i momenteve më karakteristike të punës së paraleles*.

Neni 19.9 Shqiptimi i masës disiplinore: *Pezullim i përkohshëm nga shkolla*, i shqiptohet nxënësit, i cili nuk i përfillë rregullat e shkollës, edhe pse më parë i është shqiptuar masa disiplinore: *vërejtje gojore dhe vërejtje me shkrim*.

Masa disiplinore: *Pezullim i përkohshëm nga shkolla*, shqiptohet në dy mënyra:

1. *Pezullim i përkohshëm nga garat sportive, kulturore, ekskursionet, vizitat, shëtitjet, mbrëmjet shoqërore apo ceremoni të diplomimit në rastin e semimaturantëve, etj. dhe*
2. *Pezullim nga shkolla deri në një muaj.*

Masën disiplinore: *Pezullim i përkohshëm nga garat sportive, ekskursionet, vizitat dhe shëtitjet*, e shqipton drejtori i shkollës, kurse masën disiplinore: *Pezullim nga shkolla deri në një muaj*, e shqipton DKA-ja.

Neni 19.10 Shqiptimi i masës disiplinore: *Pezullim (largim) për një vit shkollor nga shkolla*, i shqiptohet nxënësit, i cili bën shkelje të rëndë të rregullave të shkollës, të parapara UA (MASHTI) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënës të shkollave të mesme të larta dhe në baze të kësaj Rregulloreje.

Përgjegjësia për Shkatim të Demit Matrial të Inventarit të Shkollës

Neni 20

Neni 20.1 Nxënësi, i cili me qëllim ose nga pakujdesia e tepruar i ka shkaktuar dëm material shkollës, është i obliguar që të njëjtin ta kompensojë.

Neni 20.2 Në qoftë se dëmin material e kanë shkaktuar disa nxënës, atëherë ata janë të obliguar ta kompensojnë, secili për pjesën e fajit të vet.

Neni 20.3 Në qoftë se nuk mund të zbulohet fajtori i shkakimit të dëmit material, atëherë të gjithë nxënësit e klasës janë të obliguar të bëjnë kompensimin e dëmit të shkaktuar proporcionalisht.

Neni 20.4 Për kompensimin e dëmit material, kërkesa i bëhet drejtorit të shkollës, i cili për vlerësimin e dëmit e formon një komision prej tre anëtarësh, i cili bën vlerësimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 20.5 Invntarin eshte me se miri ta sjellin me prinder, po te njejtin objekt, por te ri.

Neni 20.6 Për shqiptimin e masave disiplinore, organi kompetent është i obliguar t'iu lëshojë vendim (aktvendim) me shkrim nxënësve të ndëshkuar. Për ekzekutimin e tyre kujdeset drejtori i shkollës.

Të Drejtat nxënësit për Ankesë

Neni 21

Neni 21.1 Nxënësi apo prindi i tij, përmes drejtorit të shkollës, ka të drejtë të ushtrojë ankesë me shkrim kundër shqiptimit të masës disiplinore: *Vërejtje me shkrim* dhe masës disiplinore: *Pezullim i përkohshëm nga garat sportive, ekskursionet, shëtitjet, etj.*, në afat prej 3 ditësh, pranë Këshillit të shkollës.

Neni 21.2 KDSH duhet të marrë vendim dhe t'i bëjë shkollës njoftim me shkrim brenda 10 ditësh.

KAPITULLI IX

Punëtorëtoët të Mirmëmbajtjes

Neni 22

Punëtorët teknik duhet të jenë në vendin e tyre të punës në orën 7:00 DERI NE OREN 15:00.

Secili punëtor ka për obligim të jetë në vendin e duhur duke respektuar orarin e punës.

Punëtori teknik nuk duhet t'i lirojë nxënësit gjatë orës së mësimin, të dalin jashtë objektit shkollor pa lejen e drejtorit.

Punëtori teknik duhet ta informoj drejtorin e shkollës për çdo palë (mysafir) dhe duhet përcjellur ata deri tek zyra e drejtorit.

Zilja e shkollës duhet të bjerë në kohë, sipas orarit të caktuar .

Dera e jashtme e oborrit duhet të rrijë mbyllyr (me dry), përveçse nga ora 7:30-8:00 dhe 9:30-10:00.

Punëtori teknik nuk duhet ta lëshoj vendin e punës pa leje nga drejtoria.

Secili punëtor duhet ti kryej punet e veta, te ndara per mirembajtje dhe pa i perfunduar punet ditore nuk mund te lirojnë vendin e punës.

KAPITULLI V

Rojet e Shkollës

Neni 23

Neni 23.1 Detyrat dhe përgjegjesit e Rojës se Objektivit të Shkollor

1. Secili rojtar shkollë përgjigjet per sigurine dhe sigurimin e objektit shkollor, paisjeve, pasurise dhe burimeve tjera qe jane te lidhura drejtperdrejte me shkollen.
2. Të paraqiten në punë dhjetë minuta para kohës dhe të pranojnë detyrën nga punëtori tjetër/ ndihmës i cili medoemos duhet të jetë prezent gjatë marrjes së detyrës dhe të raportoj gjendjen e objektit para e ta marrë rojtari.
3. Nëse punëtori ndihmës nuk e pret në vend të punës rojtarin, atëherë ai duhet ta lajmërojë zyrtarin administrativ ose drejtorin e shkollës, se ka gjetur shkollën pa mbikqyrje.
4. Pranim dorëzimi i detyrës bëhet me shkrim në prani të dy palëve dhe të evidentohen momentet karakteristike, të gjeturat apo objekti pranohet në gjendje të rregulltë.
5. Në rast se rrezikohet pasuria e shkollës, sa më shpejtë që është e mundur të lajmërohet Policia e Kosovës, zyrtari administrativ dhe drejtori i shkollës.
6. Nëse objekti në çfarëdo mënyre rrezikohet nga uji ose dëbora, roja të marrë masat e nevojshme për evitimin e rrezikut nga pasojat e mundshme.
7. Nëse gjatë natës bie borë, atëherë në mëngjes duhet të hapet rruga për nxënës në të dy hyrjet e objektit shkollor.
8. Gjatë kohës sa janë në roje, iu ndalohej sjellja e personave tjerë në shkollë pa lejen e drejtorit të shkollës.
9. Kujdesen për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe rregullimin e hapësirës ku qëndrojnë gjatë orarit të punës.
10. Kursejnë energjinë elektrike, duke i fikur të gjitha dritat nëpër klasë dhe korridore, gjithashtu edhe nëse lëvizë diçka ndezen dritat sensorike dhe lehte identifikohen personat e paautorizuar.
11. Kontrollojnë dhe mbyllin të gjitha dyert dhe dritaret gjatë natës.
12. Kontrollohen të gjitha shportat e mbeturinave së bashku me punëtorin ndihmës në mënyrë që të evitohet rreziku nga zjarri.
13. Të kenë kujdes të veçantë me aparatet elektrike, ngrohëset/nxemëset elektrike, bojlerët si dhe reshjoja të mos jetë e kyçur në rrymë elektrike.
14. Të kontrollohet uji në tërë hapësirën e shkollës, të mbyllën bateritë (çepat e çeshmeve), nëse është i hapur ndonjë edhe pse shumica janë me siguresa, duhet kontrolluar për prishje eventuale.
15. Roja e natës (apo e ditës) për asnjë çast nuk guxon të largohet nga vendi i punës, pra objekti shkollor duhet të jetë në mbikqyrje, tërë kohën.
16. Nëse i caktohet ndonjë detyrë tjetër gjatë orarit të punës nga zyrtari administrativ apo drejtori i shkollës, duhet ti kryejë patjetër.
17. Nëse për shkaqe shëndetësore apo ndonjë arsye tjetër nuk ka mundësi të paraqitet në vendin e punës, duhet të lajmërojë zyrtarin administrativ, rojen që pret në shkollë dhe drejtorin e shkollës.
18. Roja e natës apo punëtorët ndihmës nuk guxojnë të lëshojnë vendin e punës edhe nëse vonohet ndërrimi, por obligativisht janë të detyruar të evidentojnë në fletoret e kujdestarisë së rojeve, vonesat dhe emrin e punëtorit i cili mungon ne vend pune.

Neni 23.2 Respektimi i Kontratës nga Rojet e Shkollës konform te drejtave dhe detyrimeve buron nga ligji i punës dhe dispozitave tjera qe prekin te drejtat e te punsuarit.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 24

Neni 24.1 Komentimin, interpretimin, ndryshimin, plotësimin dhe harmonizimin e mëtutjeshëm me dispozita më të reja ligjore dhe me udhëzime administrative të kësaj Rregulloreje, e bën Këshilli i shkollës.

Neni 24.2 Me miratim nga kshilli Drejtues i shkolles e shfyqizon rregulloren ne Fuqi.

Neni 24.3 Për çdo dispozitë të kësaj Rregulloreje që është në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të udhëzimeve përkatëse administrative, do të vlejnjë dispozitat e ligjit dhe udhëzimit përkatës.

Neni 24.4 Kjo rregullore përbën disa anekse, konform rregullores:

Hyrja ne Fuqi

Neni 25

Kjo rregullore hyne ne fuqi me miratim nga Kshilli Drejtues të Shkollës

Klinë:16.06.2023

Drejtori: Ilir Keka



Aneksi

(Obligimet për nxënësit)

MBAJE NË MEND:

1. Secili nxënës ka për detyrë që të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët.
2. Secili nxënës ka për detyrë që t'i respektojë të tjerët.
3. Kjo do të thotë se në shkollën tonë nuk do të lejohet që ndaj ndonjërit prej nxënësve të përdoret dhuna dhe agresiviteti fizik dhe psikik, duke përfshirë edhe lojërat "luftarake".
4. Për sjellje jo të mira çdoherë duhet të jipet përgjegjësi.
5. Në raste të tilla vjen deri te biseda me prindin, kujdestarin, drejtorin, raportimi, dënimi për një kohë të caktuar ose detyrimi për kryerjen e ndonjë shërbimi (varësisht nga pesha e gabimit)
6. Në raste më serioze, nxënësi mund të largohet nga shkolla për një kohë të caktuar e pastaj të kthehet së bashku me prindin/kujdestarin që të shqyrtohen hapat e ardhshëm.
7. Në rast se nuk ka përmirësime, nxënësi largohet përgjithmonë nga shkolla.
8. Shkolla jonë synon t'i përkrah nxënësit me sjellje të mira, me vetë-disiplinë dhe nxënësit me vullnet për mësim.
9. Kur nxënësi silltet mirë dhe tregon rezultate në mësim, kjo do të vlerësohet nga mësimdhënësi/ja apo nga kujdestari/ja e klasës.
10. Nëse nxënësi tregon rezultate të mira në mësim apo aktivitete tjera, ai/ajo do të shpërblehet.
11. Nëse ndiheni të ofenduar për shkak të asaj që ju kanë thënë apo bërë të tjerët, keni të drejtë të kërkonti që
12. diçka e tillë të ndërpritet.
13. Së pari ju duhet t'i drejtoheni kujdestarit të klasës, cilitdo mësimdhënësi, drejtorit të shkollës apo ndokujt në familje të cilët do të jenë në gjendje që të të ndihmojnë.
14. Në shkollë nxënësi lejohet të sjellë vetëm gjëra të nevojshme për procesin arsimor.
15. Nxënësi është përgjegjës për çdo gjë që e sjellë në shkollë, nëse humbet apo vidhet, duhet përsëri të kompensohet.
16. Rreptësisht është e ndaluar mbajtja e telefonit në shkollë nga ana e nxënësve.
17. Nëse mësimdhënësi e vëren telefonin në klasë, ai do ta konfiskojë atë, do të dorëzohet në drejtorin dhe deri në fund të vitit shkollor nuk do të mund ta terhjek, dorëzimi i telefonit celular behet vetëm njerit prej prindërve (në fund të gjysmëvjetorit).
18. Rreptësisht ndalohet të sillen në shkollë cigare, shkrepsa, mjete të forta apo çfarëdo tjetër që do të mund të lëndojë këdo.
19. Edhe pse në mundohemi shumë t'i mësojmë njerëzit që ta respektojnë pronën e të tjerëve, megjithatë ka njerëz që i vjedhin gjërat e pa mbikqyra. Prandaj, nëse nxënësi do të kërkojë që gjërat e tij të vlefshme të mos vidhen, atëherë këshillohet që t'i mbikqyrë apo të mos i sjellë në shkollë fare.
20. Në rast të gabimeve, që mësimdhënësi kujdestar apo drejtori i shohin si të mëdha për tu dënuar, që të mos përsëriten kanë të drejtë që të dënojnë nxënësit me:
21. Pastrim të oborrit shkollor,
22. Pastrim të toaleteve,
23. Pastrim të trotuareve pranë shkollës (me mbikqyrje nga pastruesit e shkollës).

Aneksi 2.

PREMTIMET E NXËNËSVE:

UNË DO TA RESPEKTOJ VETVETEN

Unë e kuptoj se shkolla ime më ofron një fillim të mrekullueshëm në jetën time, prandaj do të mundohem të përfitoj sa më shumë nga kjo, e kjo arrihet nëse:

- unë dëgjoj gjatë orës së mësimi dhe bashkëpunoj me të tjerët,
- unë do të jem i/e saktë në shkollë (me vete te kem mjetet mesimore, uniformen dhe pandoflet dhe do t'i kryej obligimet e mia me kohë,
- unë nuk do të lejoj që të tjerët të ma tërheqin vëmendjen më shumë se mësimi.
- mbi të gjitha unë do t'i caktoj synimet e mia dhe do ta detyroj vetveten t'i përmbush ato, si dhe do të punoj me arsimtarët e mi dhe me familjen time që të sigurohem se jam duke e shfrytëzuar maksimumin e mundësive të mia.

UNË DO T'I RESPEKTOJ TË TJERËT

1. *Unë jam i/e vetëdijshëm se edhe të tjerët meritojnë t'u jipet e njëjta shansë sikurse edhe mua, prandaj unë nuk do të bëj asgjë që do t'i pengonte ata.*
 - unë do të sigurohem se ata i kanë të qarta mësimet dhe detyrat, pa i bezdisur ata.
 - unë e kuptoj se njerëzit janë të ndryshëm e kjo e bën mjedisin tonë më tërheqës, prandaj unë do të jem tolerant dhe i intersuar në ndryshimet që të tjerët sjellin.
 - unë nuk do të jem i dhunshëm apo agresiv.
 - unë e di se t'i përqeshësh apo t'i ofendosh të tjerët nuk është aspak e këndshme, prandaj unë kurrë nuk do të bëj një gjë të tillë.
 - unë do ta respektoj gjithë personelin shkollor si dhe do të jem mirënjohës për mundin e tyre të dhënë për edukimin tim.

2. UNË DO TA RESPEKTOJ SHKOLLËN TIME

3. *Unë e di se shumë kohë, mund dhe para janë dhënë për t'u ndërtuar kjo shkollë për mua, duke më ofruar atë që unë e meritoj, prandaj unë jam krenar/e për këtë.*
 - unë do të kontribuoj që shkolla ime të duket sikur në ditën kur për herë të parë është hapur.
 - unë e kuptoj se mjetet dhe pajisjet që ndodhen këtu janë në shërbim të të gjithëve, përfshirë edhe mua, prandaj do të kujdesem që të mos dëmtoj asgjë, si dhe nuk do të shfrytëzoj apo marr asgjë që nuk më nevojitet.
 - unë nuk do të bëj asgjë që do ta rrezikojë këtë ndërtesë të mrekullueshme.

4. *Unë do të mbaj dhe do të jem i/e kujdesshem/me në ambientin shkollor, respektoj rendin, disiplinën dhe*

5. *pastertinë.*

6. UNË DO TË JEM PËRFAQËSUES I MIRË I SHKOLLËS SIME

7. *Unë e kam të qartë se jam përfaqësues i rëndësishëm i shkollës sime, prandaj do të sillem me respekt dhe pjekuri kur ndodhem jashtë shkollës.*
 - unë nuk do të ngatërrohem me askë dhe nuk do të përdor fjalë të ndyra në rrugë,
 - nëse të tjerët nuk sillen mirë me mua unë nuk do t'i injoroj ata por do mundohem se bashku me drejtorinë e shkollës dhe mesimdhënesit të rregullojme gjerat.

Aneksi 3.

UDHËZUES I VEPRIMIT NË RAST DHUNE NË MES NXËNËSVE

1. Në rast të paraqitjes apo rasteve potenciale të shkaktimit të dhunës fizike në mes nxënësve, shkolla është e obliguar të ndermerr këta hapa:
 - a. Fillimisht, të ftohen prindërit e involvuara në dhunë fizike, si dhe dëshmitarët, t'ju ftohen prindërit, dhe në rastet e rënda apo ato kur nuk dakordohen prindërit, të ftohet policia.
 - b. Në rast se nxënësi është i lënduar aq sa për tu trajtuar nga mjekët, fillimisht duhet dërguar në shtëpi me të afërt të shëndetit, e pastaj të ftohen prindërit dhe të dakordohen në drejtori.
 - c. Të lënduarit, apo viktimës duhet dhënë përkrahje morale, me bisede të shkurtra dhe të kujdesshme psikologjike. Gjithashtu, edhe prindërit të tij/saj t'iu ipen këshilla për qetesim të mëtejme.
2. Me nxënësin që ka shkaktuar dhunën, të bisedohet seriozisht për masat parandaluese të ushtrimit të dhunës në të ardhmen.
3. Të ftohen prindërit e nxënësit që ka shkaktuar problemin ose dhunën ndaj shokut-shoqes dhe të njoftohen me rrjedhat e incidentit. T'iu shpjegohet se dështimi është e papranueshme dhe e demshme. Gjithashtu, prindërit njoftohen se rasti do të paraqitet në DKA ose Qendër për Punë Sociale..
4. Fajtori patjetër të kërkojë falje të demtuarit në mënyrë që të i njëjti të kthehet vetëbesimi dhe të kompensohet dëmi material (nese ka të tillë). Këto nuk mund të bëjnë prindërit në emër të fëmijës, sepse fajtori nuk do të ndiente pasojat e veprimeve të tij.
5. Shkolla është e obliguar që për masat e ndermarra, bisedat, deklaratat dhe të gjeturat vetanake të bëjë procesverbal zyrtar si dhe të mbajë evidence konfidenciale të cilat do të dorëzohen organeve përkatëse për masat e mëtejshme.

Aneksi 4.

DREJTIME PUNE PËR MËSIMDHËNËSIT

1. Mësuesit duhet të kuptojnë angazhimin e tyre në edukimin e nxënësve, në mënyrë të plotë e të thellë.
2. Ata duhet të kenë:
3. Kompetencë specifike në lëndën e tyre si dhe kompetencë psiko-pedagogjike bashkëkohore.
4. Gatishmëri të vazhdueshme dhe vëmendje të kujdesshme në lidhje me të gjitha nevojat dhe kërkesat e nxënësve.
5. Mësuesit duhet të mundohen të kuptojnë objektivat specifike të Shkolles.
6. Për një mësimdhënie të lirë, të ndërlidhur me vlerat e planit vjetor të miratuar, mësuesit duhet të zbatojnë këto detyra:
7. Të marrin pjesë seriozisht në aktivitetin edukativ e mësimor.
8. Të thellojnë më shumë formimin e tyre profesional .
9. Të marrin pjesë aktivisht në nismat shkollore dhe jashtëshkollore të propozuara nga drejtoria.

Aneksi 5.

LIDHJET SHKOLLË - FAMILJE

1. Në shkollë prindërit dhe mesimdhënësit janë përgjegjës kryesorë për edukimin e fëmijëve.
2. Shkolla duhet të bëjë ç'është e mundur, që të nxisë e mirëpresë me dashamirësi bashkëpunimin e prindërve.
3. Përfaqësuesit e prindërve të klasave formojnë Keshillin e Prindërve të shkollës.
4. Keshilli i Prindërve zhvillon aktivitetin e tij në marrëveshje për çdo gjë me Drejtorinë e shkollës e mësuesit kujdestare të klasave.
5. Mbledhjet e prindërve bëhen në bazë klase e shkolle dhe zhvillohen në ambientet e shkollës. Data dhe orari i zhvillimit të tyre duhet të bashkërendohet me Drejtorinë.
6. Mbledhjet zhvillohen jashtë orarit mësimor.
7. Vendimet e mbledhjes së prindërve i komunikohen Këshillit të Arsimitarëve.